



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 2267 Prot

Shkodër, më 26/12/2019

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacion

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër


Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim relacion dhe projekt-vendim :

“Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira (me procedurë konkurruese) me afat 10 vjecar, të objektit : ‘Kinema Millenium’ ndodhur në zonën kadastrale 8593, pasuria me nr. 4/732, 4/731, me adresë : blv “Skënderbeu”, në pronësi të bashkisë Shkodër”

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Voltana ADEMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2019

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë ____ . ____ . 2019

“PËR

**DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIE ME QIRA (ME PROCEDURË
KONKURRUESE) ME AFAT 10 VJECAR, TË OBJEKTIT : ‘KINEMA
MILLENIUM’ NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8593, PASURIA ME NR.
4/732, 4/731, ME ADRESË : BLV “SKËNDERBEU”, NË PRONËSI TË BASHKISË
SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës __, __, 2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë mbështetur në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1.2, neni 36 germa ‘a’, neni 54 germa “e/1” të ligjit nr.139/2015 “Për veteqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar; ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar ; ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar; VKM 421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut Shkodër’ të ndryshuar ; VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar; sipas Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër.

VENDOSI :

1. Dhënie pëlqimi për dhënie me qira (me procedurë konkurruese) me afat 10 vjecar, të objektit : ‘Kinema Millenium’ ndodhur në zonën kadastrale 8593, pasuria me nr. 4/732, 4/731, në adresë : Blv ‘Skënderbeu’ , në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas gent planit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR


Voltana Ademi

ZvKryetar

Drejtoria Juridike

Drejtoriae Financës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. Prot.

Shkodër, me ___/___/2019

RELACION
"PËR

**DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIE ME QIRA (ME PROCEDURË KONKURRUESE)
ME AFAT 10 VJECAR, TË OBJEKTIT : 'KINEMA MILLENUM' NDODHUR NË
ZONËN KADASTRALE 8593, PASURIA ME NR. 4/732, 4/731, ME ADRESË : BLV
"SKËNDERBEU", NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR"**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqëria "I.D.A." Sh.A me datë 24.03.2000 kanë lidhur kontratë qiraje për Objektin « Kinema Republika », Shkodër me objekt të kësaj kontrate dhënia me qira e një sipërfaqe prej 1133m², prej së cilës nën objekt 667m², me afat kohor 20 vjet, me vlerë qiraje mujore 667 (gjashtëqinde gjashtëdhjeteshtate) USD dhe 2796 (dymijëeshtatëqindëntëdhjetëegjashtë) lekë.

Objekti " Kinema Republika", sot Kinema Millenium ndodhet në zonën kadastrale 8593, në pasurinë me nr. 4/732, 4/731, në rrugën Bulevardi Skenderbeu.

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit për aktivitet kinematografik, qendër kulturore dhe aktivitete sociale.

Objekti "Kinema Millenium", është transferuar në pronësi të bashkisë Shkodër me VKM nr. 421, datë 2.6.2010. "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës".

Bashkia Shkodër ka monitoruar kontratën e qirasë me subjektin "I.D.A." Sh.A nga ku rezulton se subjekti ka shlyer detyrimet rregullisht deri në Nëntor 2019.

Kontrata e qirasë përfundon me datë 24.03.2020.

Sa sipër referuar dispozitave ligjore, procedura ka afatet e përcaktuara dhe në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, gërma "e", kërkojmë miratimin nga ana e juaj për dhënie pëlqimi për dhënie me qira (me procedurë konkurruese) me afat 10 vjecar, të objektit : 'Kinema Millenium' ndodhur në zonën kadastrale 8593, pasuria me nr. 4/732, 4/731, me adresë : Blv "Skënderbeu", në pronësi të Bashkisë Shkodër.

Duke ju falenderuar!

ZV/Kryetar

Drejtorja Juridike

Drejtorja e Financës

KRYETAR

Vojtana Ademi